



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, 4.4.2024

- Lënda:** Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 4.4.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Erion Pano.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese.

*Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,*

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 6.1.2023 dhe parashtrimeve të paraqitura në seancën e datës 7.3.2024, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

**1.** Komisioni, nga hetimi administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë, bazuar në përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: [...] *ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën Vetting dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit [...]¹.*

1.1 Komisioneri Publik, sikundër trajtuar dhe në ankimin e datës 6.1.2023, vlerëson jo të drejtë konstatimin e Komisionit, *pasi lidhur me shkakun ankimor mbi pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 92,8 m², ndodhur në Tiranë, në vlerën 61.000 euro, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjit, në seancën e datës*

¹ Për më tepër referohuni në fq. 44, të vendimit të Komisionit.

7.3.2024, nuk arriti të provojë vërtetësinë e deklarimeve dhe burimet e ligjshme të përdorura për pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament në vitin 2010.

1.2 Sikundër trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit, *përsa i përket burimit të deklaruar të këstit të parë, në vlerën 25.000 euro*, për të cilën subjekti ka deklaruar se ka përdorur *huanë në shumën 10.000 euro marrë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*. dhe 15.000 euro para të tërhequra në datën \*\*.6.2008 të investuara në bono thesari (dhe poseduar në cash)*, Komisioneri Publik, vlerëson se, edhe pas shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimin e deklaruar *“kursime të poseduara në cash”*.

1.3 Komisioneri Publik, sjell në vëmendje jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, se kur si burim për krijimin e një pasurie deklarohen prej subjekteve të rivlerësimit kursime të poseduara në *cash*, këto të fundit, nisur për nga natyra e tyre, duhet të llogariten sikundër deklarohen nga vetë subjektet e rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, të cilat në kuadër të këtij procesi marrin vlerën e provës<sup>2</sup>. Sikundër trajtuar gjerësisht edhe në ankim, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi kursimet në *cash* në deklaratat periodike vjetore, deklaratimet e tij gjatë procesit të hetimit administrativ<sup>3</sup> dhe deklaratimet e dhëna në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së<sup>4</sup>, mbi të cilat duket se Komisioni ka bazuar dhe vendimarrjen e tij, janë kontradiktore dhe të pasakta, duke e pamundësuar kështu gjurmimin dhe përllogaritjen e saktë të tyre, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave të deklaruara të përdorura për pasurinë *“apartament me sip. 92,8 m<sup>2</sup>”*. Pasaktësia në deklarime të kursimeve *cash*, rezulton të jetë konfirmuar edhe nga vetë subjekti në parashtrimet e depozituara në Kolegj në seancën e datës 7.3.2024<sup>5</sup>.

1.4 Për sa i përket burimit të deklaruar *“të ardhura nga bono thesari”*, Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>6</sup>, përsa kohë nuk është deklaruar posedimi i kursimeve në *cash* nga ana e subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 (viti kur është tërhequr shuma nga llogaria rrjedhëse) dhe as në vitin pasardhës 2009, si dhe nuk rezultojnë të jenë deklaruar në DV-2010 këto kursime si një nga burimet e pagesës së këstit të parë të pasurisë apartament banimi, ato nuk mund të konsiderohen në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të shumës 25.000 euro.

1.5 Për më tepër, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve të deklaruara në *cash* për periudhën 2003-2007, të cilat më pas janë depozituar në formën e bonove të thesarit dhe tërhequr në vitin 2008 si më sipër trajtuar, mbeti e paprovuar<sup>7</sup>.

<sup>2</sup> Për më tepër referohu në vendimit (JR) nr. 11/2019, etj..

<sup>3</sup> Për më tepër referohuni përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 2 dhe pas rezultateve të hetimit administrativ.

<sup>4</sup> Procesverbalet e mbajtura në vitet 2013 dhe 2016.

<sup>5</sup> Faqe 18 e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit.

<sup>6</sup> Për më tepër referohuni vendimit (JR) nr. 13/2021, prg. 54-55 dhe vendimin nr. 35/2021, prg. 16.8.

<sup>7</sup> Komisioneri Pubik ka vënë në dispozicion të Kolegjit në seancën e datës 7.3.2024 analizën financiare të viteve respektive mbi pamjaftueshmërinë e konstatuar në ankim në shumën – 1.235.663 lekë.

1.6 Në përfundim, për këtë shkak ankimi, *Komisioneri Publik*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit, për sa i përket burimeve të ligjshme dhe pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar për mbulimin e kursimeve të deklaruara deri në vitin 2007, e ndërlidhur kjo me pamjaftueshmërinë e konstatuar për pagesën e këstit të parë të apartamentit me sip. 92,8 m<sup>2</sup> në mars 2010, sikundër trajtuar në paragrafin 1.4 më lartë. Sa më sipër, së bashku dhe me diferencën negative prej të paktën - 361.551 lekë (konstatuar edhe nga Komisioni për vitin 2016), e bëjnë deklarimin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik i qëndron shkakut ankimor për tri çështjet e procedimeve penale<sup>8</sup>, ku subjekti i rivlerësimit, z. Pano, ka kryer veprime hetimore të caktuara në përmbushje të ushtrimit të ndjekjes penale dhe janë evidentuar të meta dhe mangësi të cilat, të vetme, nuk mund të shërbejnë si bazë për aplikimin e masës së parashikuar në nenin 61, pika 4 të ligjit 84/2016.

### **I. Kërkimi përfundimtar i ankimit.**

3. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Erion Pano.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**

---

*Sqarim:* në analizën financiare të vënë në dispozicion të Kolegjit, shpenzimet e jetesës janë shprehur gabimisht me termin: “sipas përbërjes familjare me *katër* persona”, ndërkohë përlogaritja dhe vlera i korrespondojnë përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit, prej *tre* persona për periudhën e analizuar 2003-2007.

<sup>8</sup>(1) Procedimi penal me nr.\*\*\*/ 2010 me kallëzues shtetasin \*\*\* \*\*\*; (2) Procedimi penal me nr.\*\*\*, të vitit 2018 me kallëzues, shtetasin \*\*\* \*\*\*; (3) Procedimi penal me nr.\*\*\*, të vitit 2018 me kallëzuese, zonjën \*\*\* \*\*\*.